

ILIR METAJ



Datëlindja: 01.12.1973

Vendlindja: Vlorë

Email: Ilir.Metaj@parlament.al

Jetëshkrimi:

Z. Metaj është diplomuar për marketing, pranë fakultetit të Tregtisë, dega Administrim Biznesi në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë. Ai është zotërues i gjuhës angleze dhe italiane dhe është autor i disa publikimeve në lidhje me turizmin dhe ka marrë pjesë në disa panairë ndërkombëtare të turizmit.

Z. Metaj ka qenë futbollist profesionist në KS “Flamurtari”, Vlorë. Në vitin 2003 ka qenë drejtor i turizmit dhe Programim-Zhvillimit në Bashkinë e Vlorës. Më pas, në këtë bashki ka qenë drejtor i Qendrës së Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve. Nga viti 2016 e në vijim punon si drejtues rajonal për zhvillimin e biznesit në ABI Bank. Ai është anëtar i PS prej vitit 2002.